



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Mbi procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektet e rindërtimit të objekteve të shembura nga tërmeti i datës 26 nëntor, 2019.

Pas fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti i datës 26.011.2019, në kuadër të rindërtimit të objekteve të shembura (objekte banimi, institucione arsimore etj), Agjencia Kombëtare e Mjedisit Ju bën me dije si më poshtë:

Në bazë të Shtojcave I dhe II, të Ligjit 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, do të përjashtohen nga procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, ato projekte që do të ngrihen mbi të njëjtin truall dhe që do të respektojnë të njëta kondicione urbanistike me objektin ekzistues.

Në rast se projektet e rindërtimit do të kenë ndryshime thelbësore si zgjerim në sipërfaqe, në funksion etj, zhvillimi i projektit shoqërohet me ndikim në mjedis dhe duhet t’i nënshtrohet procedurave të VNM-së.

Për lehtësi procedurash, lutemi drejtoheni zyrtarisht pranë AKM-së, ku kërkesa për vlerësimin e procedurës duhet të përmbajë një përshkrim të shkurtër të projektit, skica, planimetri, sipas të cilave do të bëhet krahasimi i ish-objektit me projektin e ri.

Gjatë fazës së punimeve, ju sjellim në vëmendje se zhvilluesi duhet të ketë parasysh:

*Menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore;

*Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" dhe për asnjë arsye mos të ketë hedhje të tyre pranë burimeve ujore;

*Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët, si dhe të gjitha detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.